Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/574
Datë: 16.09.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 04.09.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Riakreditohet** Institucioni "Deutschzentrum Kosovo" me adresë: Prishtinë Rr. Musine Kokalari Nr.12A, në Dardani, 10000 Prishtinë, dhe me dy nëndegët në Gjilan dhe Mitrovicë, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 24.06.2024 deri 23.06.2029, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

1. **Kurse të Gjuhës Gjermane A1 - C1**, institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit sipas të dhënave si vijon:

1.1. **Dega kryesore 1** - "Deutschzentrum Kosovo", me adresë Rr. Musine Kokalari Nr.12A, në Dardani, 10000 Prishtinë. Institucioni në këtë degë mund të realizoj procesin e aftësimit me 10 mësimdhënës x 4 grupe x 16 nxënës për grup 640 nxënës për një nivel. Gjithsej 2560 nxënës brenda vitit kalendarik.

1.2. **Dega 2** - "Deutschzentrum Kosovo", me adresë Rr. Adem Jashari, Nr.16, 60000 Gjilan. Institucioni në këtë degë mund të realizoj procesin e aftësimit me 5 mësimdhënës x 4 grupe x 16 nxënës për grup 320 nxënës për një nivel. Gjithsej 1280 nxënës brenda vitit kalendarik.

1.3. **Dega 3**- "Deutschzentrum Kosovo", me adresë Sheshi Adem Jashari, Mitrovicë. Institucioni në këtë degë mund të realizoj procesin e aftësimit me 3 mësimdhënës x 4 grupe x 16 nxënës për grup 192 nxënës për një nivel. Gjithsej 768 nxënës brenda vitit kalendarik.

II. Obligohet Institucioni që t'i përmbahet kushteve të përcaktuara me vendimin e Këshillit Drejtues Nr.01/402 të datës 13.06.2024.

III. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bënë monitorimin e përmbushjes së kushteve.

IV. Institucioni mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Institucioni "Deutschzentrum Kosovo", me datë 14.11.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë për riakreditim të institucionit për kualifikimin: Gjuhë Gjermane, niveli A1-C1sipas KPERGJ dhe e cila në AKK është protokolluar dhe ka marrë numër 01/711.
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushëveprimtaria e AKK-së ka caktuar ekipin e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për riakreditim për kualifikimin si më lartë.
Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit, me datë 17,18,19 Korrik 2024 kanë realizuar vizitat në institucionin "Deutschzentrum Kosovo", ndërsa pas përfundimit të procesit vlerësues, me datë 24.07.2024 kanë përpiluar raportin vlerësues përfundimtar për riakreditim për kualifikimin për të cilin institucioni ka parashtruar kërkesë bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës. Raporti vlerësues i ekipit të ekspertëve është proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 04.09.2024.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacioni për riakreditim të institucionit, raporti i vetëvlerësimit i dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitës së realizuar tek pala aplikuese.

Këshilli Drejtues i AKK-së me qëllim të zbatimit të drejtë të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë ka nxjerr vendimin Nr.01/402 të datës 13.06.2024, sipas të cilit janë të përcaktuara kriteret që Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional duhet ti përmbushin në afat kohor 3 deri 6 muaj. Ndërsa AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/ 03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së në bazë të kërkesës së Institucionit "Deutschzentrum Kosovo" për riakreditim, rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve, të dhënave në raportin vlerësues për riakreditim për institucionin aplikues, të gjeturave në raportin vlerësues, si dhe nga të lartcekurat vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:
- "Deutschzentrum Kosovo",
- Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së